Re: Kërkesë për konfirmim vlefshmërie të urdhrit të arkëtimit të truallit – Osmen Çulli (në emër të Hjalit Eduard Çulli)

From: Bashkia Sarande (bashkiasarande@yahoo.com)

[redacted]

Date: Thursday, October 16, 2025 at 12:48 PM GMT+2

[redacted]

Në përgjigje të kërkesës suaj , administruar elektronikisht më datë 22.09.2025 , lidhur me pagesën dhe përfundimin e kalimit të pronësisë për parcelën [redacted] informojmë si më poshtë:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.329 datë 22.05.2019 "*Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me agjensinë shtetërore të kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi*", ka për qëllim përfundimin e procedurave të kalimit të pronësisë mbi troje të dhëna nga njësitë e qeverisjes vendore dhe rregjistrimin e akteve të kalimit të pronësisë pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës.

Objekt i këtij vendimi janë tokat e dhëna për qëllime ndërtimi nga bashkitë, ish-komunat dhe ish-këshillat e rretheve. Sipas pikës 3 kanë të drejtë të përfitojnë nga dispozitat e këtij vendimi subjektet që, sipas rastit :

a) janë pajisur nga organet vendore me dokumentacion pronësie mbi tokën, pavarësisht mangësive në procedurë. Këto subjekte përfitojnë regjistrimin e dokumentit të pronësisë ose heqjen e kufizimit nga regjistri, pas plotësimit të mangësive, sipas rregullave të këtij vendimi; ose

b) nuk janë pajisur nga organet vendore me dokumentacion pronësie mbi tokën, por për ta është ***miratuar të paktën vendimi i këshillit të organit vendor për dhënien e truallit për ndërtim, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi***. Në favor të këtyre subjekteve përfundohen procedurat e kalimit të pronësisë dhe kryhet regjistrimi i dokumentacionit të pronësisë dhe/ose heqja e kufizimit nga regjistri, sipas rregullave të këtij vendimi.

Rezulton se Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.89 datë 28.12.2005 "*Për miratimin e riparcelimeve të shësheve të ndërtimit*" sipas shkresës nr. 16/3 prot. datë 13.02.2006 nuk është i shprehur i ligjshëm nga ana e Prefektit të Qarkut Vlorë , dhe në këto kushte, Bashkia Sarandë nuk mund të vijoj e procedurave administrative për përfundimin e kalimit të pronësisë bazuar në këtë vendim, dhe rrjedhimisht ju nuk mund të vijoni për kryerjen e pagesave përkatëse.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

BASHKIA SARANDE
Adresa: Rruga "ABEDIN DINO"Nr 11, SARANDE
Fax/ Tel: 00355(0) 85222380
E-mail: bashkiasarande@yahoo.com
Home page: www.bashkiasarande..gov.al

On Monday, September 22, 2025 at 10:27:33 PM GMT+2, Osmen Culli <osmenculli53@gmail.com> wrote: